



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit ne organizimin e njeriut", të ndryshuar". (Komision për dhënie mendimi)

2. Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe". (Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Robert Bitri, Eglantina Gjermani Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Klajdi Qama, Zef Shtjefni, Ardit Konomi dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani, Halit Valteri dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Bora Kola – Specialiste e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Enea Hoti – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Zamir Dedej – Përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marika – Drejtoreshë e Biodiversitetit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Duke qenë se u lajmërua pak vonë mbledhja, me zor e plotësua kuorumin.

Kjo është mbledhja e datës 6 nëntor e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, e parashikuar në orën 11:00, ora është 11:28 dhe do të vazhdojmë shqyrtimin, ndoshta sot do të bëjmë edhe votimin, e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.06.2008 "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", të ndryshuar””. Relator është zoti Besnik Baraj.

Rikujtoj që kemi zhvilluar dy seanca të tjera, njëra ka qenë seancë dëgjimore me grupet e interesit, ndërsa seanca tjetër ka qenë e përbashkët me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, për të rakorduar qasjet dhe mendimet për këtë projektligj. Me kontributin e përfaqësuesve të institucioneve, kryesisht të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (zëvendësministri ka qenë në të dyja takimet, ndërsa sot kemi prezent sekretarin e Përgjithshëm), besoj se kemi arritur disa qartësi nga ndryshimet që i janë bërë këtij projektligji. Ndaj sot besoj që do të arrijmë t’i dalim në krye për t’ia parashtruar pastaj rekomandimet tona Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, që është edhe komisioni përgjegjës.

Po ia jap fjalën fillimisht relatorit për një përmbledhje të shkurtër deri ku jemi dhe si do t’i zhvillojmë më tej diskutimet.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Ne bëmë një mbledhje, ku ishte edhe komisioni tjetër dhe, përgjithësisht, propozimet e bëra nga Ministria e Bujqësisë u pranuan nga përfaqësuesit e komisionit përkatës, që është edhe komisioni përgjegjës për këtë projektligj. Por edhe ne, me sa vura re, jemi dakord që të pasqyrohen këto ndryshime, sepse e bëjnë ligjin më koherent dhe sqarojnë disa momente që mund të jenë evazive dhe mund të sjellin problematika njëkohësisht edhe për aktorët e tjerë, grupet e interesit, të cilët i pasqyruan pretendimet e tyre në takimin që patëm.

Gjithashtu, dua të theksoj edhe një fakt, meqenëse edhe me kolegët këtu mund të ndodhë ndonjë keqkuptim, absolutisht, ne jemi për kontrollin e çdo partie që futet në Republikën e Shqipërisë, porse kjo gjë duhet të ndërmerret nga shteti dhe, meqenëse është një problem i rëndësishëm shëndetësor dhe analiza nuk është me kosto, këtë gjë ta marrë përsipër shteti ta kryejë nga fillimi deri në fund. Ndërkohë, për amendimet që propozoja unë, mund të

them që me marrjen përsipër nga ana e shtetit të kontrollit të çdo partie nuk ka arsye të qëndrojnë që këto gjëra, domethënë këtë monitorim, analizë, ta bëjë vetë biznesi, pasi, veçanërisht kur vijnë nga vendet e Bashkimit European partitë e importuara, vijnë me fletëanalizë të certifikuar dhe, ashtu sikurse vijnë produktet e tjera ushqimore, unë them që shteti të bëjë detyrën e tij, pasi subjekti e ka kryer përgjegjësinë e tij, sa kohë që malli shoqërohet me fletë-analizë nga laboratorët, që janë tashmë të njohur, të certifikuar në BE e të tjera.

Mendoj që ne mund të kalojmë në miratimin nën për nën, me qëllim që propozimet e bëra të pasqyrohen në variantin që mendojmë se do të dalë nga ky komision.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka ndonjë diskutim ose pyetje nga anëtarët e komisionit? Po, zoti Shtjefni.

Zef Shtjefni – Në fakt, zoti kryetar, ne kemi katër mbledhje, me sa di unë, ndoshta tre-katër, nuk e di sa janë, ku kemi pasur paqartësi për këtë problem, sepse për importet ishte 15%, ndërsa 85% ishte, po themi, prodhim vendas...

Nisur edhe nga pyetjet që kanë bërë kolegët, edhe përfaqësuesit e ministrisë, qoftë edhe grupet e interesit, edhe unë bie dakord me zotin Baraj që t'i japim fund sot kësaj pune dhe të mos merremi më me këtë problem, pasi nuk ka asgjë për t'u zgjidhur, edhe sikur ta shtyjmë sot dhe të vijmë një herë tjetër. Unë them që sot ta mbyllim këtë punë.

Niko Peleshi – Tani, ju kujtoj, siç e tha edhe zoti Baraj, nga takimet që kemi bërë edhe me përfaqësuesit e institucioneve, herën e kaluar kishim përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilëve u kemi kërkuar ta plotësojnë këtë draftligj edhe me nene që, ashtu sikundër nenet e deritanishme, rregullojnë kontrollin e shtuar mbi kripën e importuar, të jodizuar ose për jodizim, e cila përbën 15% të tregut. Të afektohet po njësoj (pra duke shtuar vlerën në procesin e kontrollit, duke forcuar kontrollin) edhe pjesa tjetër e kripës që prodhohet dhe tregtohet në vend, që përbën pak a shumë 85% të tregut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte detyrë nga hera e kaluar.

Kemi përfaqësues këtu nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni! Deri ku jemi me propozimet që do të sillnit?

Me mikrofon, ju lutem!

Bora Kola – Propozimet janë...

Niko Peleshi – Më falni, kush jeni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bora Kola – Unë quhem Bora Kola dhe jam specialiste e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Aktualisht, drafti po shqyrtohet nga specialistët e tjerë të po kësaj ministrie dhe po konsultohet po aty. Kështu që nuk është ende i përfunduar.

Ndjesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ne e marrim si fyerje.

E para, kam shumë respekt për punën që ju bëni, por ky komision meriton të ketë përfaqësim të një niveli shumë më të lartë të ministrisë, qoftë edhe për të thënë: “Nuk jemi gati dhe nuk kemi zbatuar një kërkesë të këtij komisioni për të plotësuar projektligjin”.

E dyta, nëse ka arsye objektive, këto duhej të kishin ardhur me shkrim, në mënyrë zyrtare, sepse jemi shtet, nuk jemi kafene! Pra, duhej të na kishte ardhur një njoftim me shkrim, sepse këtu ka deputetë që vijnë nga e gjithë Shqipëria për këtë mbledhje dhe nuk vijnë t’ju dëgjojnë ju, me gjithë respektin, për të thënë: “Nuk kemi pasur mundësi ta plotësojmë draftin e ligjit me kërkesat apo sugjerimet që dolën nga disa mbledhje të komisionit”. Ne i kemi dhënë rëndësinë e merituar këtij projektligji, nuk po e trajtojmë shkel e shko, por ky projektligj arriti të shkojë deri në seancë dhe u kthye pikërisht, sepse u pa e nevojshme të plotësohet. Ne, si komision, që u përfshimë me kërkesë të parlamentit në proces, e kemi herën e tretë ose të katërt që mbledhemi për këtë projektligj dhe meritojmë pak më shumë respekt. Ju lutem, transmetojeni këtë nga komisioni!

Tani, ne kemi dy zgjedhje: të lëmë një seancë tjetër dhe të presim ministrinë të sjellë plotësimet ose, në qoftë se mendoni që mund t’ia dalim vetë të bëjmë rekomandime plotësuese të neneve në ndryshim të këtij projektligji, e vazhdojmë sot dhe më pas ministria le t’i çojë te Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë propozimet e reja. Pastaj ata të agregojnë të gjitha rekomandimet në një draft final për seancën. Si mendoni ju, si relator?

Besnik Baraj – Unë mendoj se ne duhet të punojmë mbi draftin, që vjen nga ministria, kështu që mendoj se duhet të shtyhet.

Niko Peleshi – Po, zoti Dritan.

Më pas fjalën e ka zoti Pëllumbi.

Dritan Bici – Edhe unë jam i mendimit që duhet të shtyhet, sepse ne nuk mund të shqyrtojmë një ligj, për të cilin nuk jemi të qartë vetë. Unë mendoj se ky ligj nuk duhet të jetë vetëm për kripën e importuar, por për të gjithë kripën e jodizuar, edhe për atë që prodhohet në vend. Kripa që importohet, vjen nga vendet e BE-së dhe ka standarde, por, për mendimin tim, duhet kontrolluar e gjitha. Ne nuk kemi pse të bëjmë ligje që një pjesë e biznesit të vështirësohet dhe pjesa tjetër të lehtësohet, sepse pastaj do të futemi në interesa.

Së dyti, Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë informacion edhe nga doganat për ta pasur të qartë situatën, se sa është sasia e kripës së jodizuar, e standardizuar që futet nga jashtë; sa është sasia e kripës së pajodizuar dhe sa është sasia e kripës që jodizohet në vend. Unë nuk e di se kush mund të na japë një informacion për kripën që jodizohet në vend, por për kripën e pajodizuar dhe atë të jodizuar, që futet nga jashtë, mund të na e japë dogana, në mënyrë që ne të dimë një përmbajtje të saktë. Ndoshta këto nuk kanë rëndësi, në qoftë se ne e bëjmë ligjin që të kontrollohet e gjithë kripa.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se ne, si komision, kemi harxhuar më shumë orë me këtë projektligj se me çdo projektligj tjetër. Unë besoj se kjo kohë e humbur na ka shërbyer që “t’i hedhim kripën e duhur” këtij projektligji, që do të thotë se të gjithë ne sot jemi të qartë që kemi dy kolona, me të cilat duhet të vazhdojmë punën në këtë projektligj.

Së pari, ne duhet t’i japim popullatës kripë të jodizuar arsyet që propozon Ministria e Shëndetësisë dhe komisioni përkatës. Pra, e gjithë popullata duhet të konsumojë kripë të jodizuar për të plotësuar mungesën e jodit që kemi në popullatë.

Së dyti, ne nuk duhet t’u krijojmë vështirësi bizneseve, të cilat nuk kanë lidhje me jodin në kripë, por kanë kripën e pajodizuar si element të tyre.

Në këto dy kolona ne kemi hyrë më thellë kur themi se të njëjtat procedura, që duhet të zbatohen për kripën e importit, duhet të zbatohen edhe për kripën e vendit, duke pasur gjithmonë si qëllim final këto dy gjëra që thashë, pra që popullata të konsumojë kripë të jodizuar dhe pak rëndësi ka nëse vjen nga importi apo prodhohet në vend, në mënyrë që edhe bizneset që tregtojnë kripë të pajodizuar të mos abuzojnë dhe të mos hedhin në treg kripë të pajodizur. Ne jemi të qartë për këtë gjë dhe besoj se sot jemi të gatshëm të gjithë bashkë të bëjmë ndryshimet e duhura në këtë draftligj. Çfarë do të ndodhë? Ne do të kemi një draft të ri të Këshillit të Ministrave me ndryshimet që do të propozojmë, në këtë mënyrë do t’u krijojmë

lehtësira kolegëve tanë të Komisionit të Shëndetësisë, që të mos kenë shumë drafte. Kështu, pavarësisht faktit që ne sot mund t'i bëjmë këto ndryshime, unë bashkohem me propozimin e kolegëve për ta shtyrë.

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Meqenëse këtu kemi përfaqësues nga ministria, të cilët po punojnë me draftin, dua të them se në një studim që kam lexuar, ndër të tjera, thuhet se jodi humbet shumë kur ambalazhimi është në kuti kartoni apo në qese prej letre. Kështu, meqenëse po punoni për draftin, do të ishte mirë që të pasqyrohet edhe problematika e ambalazhimit. Pra, nëse kripa është në ambalazh plastik, jodi i saj nuk humbet, por, nëse është në një ambalazh tjetër, që ka aftësi absorbuese, do të humbasë sasi e konsiderueshme e jodit deri edhe në 100%, përkundrazi, në ambalazh plastik humbja është shumë e vogël. Unë nuk kam parë që të tregtohet kripë në ambalazh kartoni, por, nëse ka, është e sigurt që jodi humbet. Pra, janë studime të mirëfillta shkencore të bëra në këtë drejtim.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord, unë mendoj se nuk duhet ndonjë shkencë e madhe për të vendosur të njëjtin regjim kontrolli si për kripën e prodhuar në vend, ashtu edhe për atë të importit. Kështu, besoj se në mbledhjen e ardhshme, e cila do të jetë në fillim të javës tjetër, ministria të ketë gati disa propozime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri ditën e premte duhet të jetë këtu, në mënyrë që në mbledhjen e ditës së hënë ose të martë komisioni të ketë mundësi t'i shqyrtojë. Ndërkohë, Dritani ka të drejtë të kërkojë me shkrim një informacion nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e cila mund ta marrë nga institucionet e saj të varësisë, nga dogana dhe tatimet, lidhur me sasinë e kripës së importuar dhe sasinë kripës së prodhuar në vend, në mënyrë që të kemi shifra zyrtare për përqindjen e jodit në treg që ka një biznes apo tjetri, por, sido që të jenë shifrat, rezultati është i njëjtë. Ne duhet të bëjmë një ligj të baraslarguar nga importi dhe nga prodhimi vendas, pra një ligj që të jetë i aplikueshëm për të gjithë tregun njëlloj, pavarësisht nga origjina e kripës.

Atëherë, para se ta mbyllim, drejtori Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, zoti Enea, ka për të thënë diçka.

Enea Hoti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, zëvendësministri i Bujqësisë i ka sjellë propozimet me shkrim, por unë dua të informoj komisionin se qeveria po mendon të kontrollojë edhe kripën në vend.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor do të shkrihet dhe një pjesë e funksioneve të tij do t'i kalojnë AKU-së, së bashku me një pjesë të personelit. Unë besoj se ky informacion do t'ju vijë edhe juve kur të vendoset se cili do të jetë institucioni që do të kontrollojë kripën në vend, sepse kam përshtypjen se edhe këtu ka pasur një diskutim të tillë. Kështu që do të ishte mirë dhe ne sugjerojmë që të jetë AKU-ja që ta kontrollojë këtë pjesë.

Niko Peleshi – Kjo është pjesë e një kakofonie dhe ne i kemi kërkuar ministrisë të na ndihmojë për të na sqaruar, sepse, në fakt, në projektligj përmenden dy-tre institucione. Pra, Inspektorati i Shëndetit Publik dhe AKU-ja pothuajse nuk përmenden fare, por kjo nënkuptohet, sepse bëhet fjalë për ushqim dhe, sa herë që bëhet fjalë për ushqim, kompetencat AKU-së për të kontrolluar nuk ia heq dot askush dhe bëhet fjalë për kontrollin në dogana. Megjithatë, kjo mbetet për t'u sqaruar. Ne do të mundohemi të bëjmë një formulim, i cili duhet t'u pararendë edhe ndryshimeve strukturore apo institucionale që ju mund të bëni, por nuk e di nëse do t'ia dalim vetë. Kështu që, edhe një herë, po e theksoj rëndësinë e rekomandimeve që vijnë nga Ministria e Shëndetësisë. A ka ndonjë diskutim, koment apo sugjerim? Nuk ka.

Atëherë, e mbyllim këtë seancë. Në lidhje me këtë çështje do të njoftoheni në seancën e ardhshme.

Po kështu sot në orën 12:00 do të zhvillojmë një seancë tjetër për shqyrtimin e një marrëveshjeje, e cila ka hyrë me procedurë të përshpejtuar. Pra, bëhet fjalë për projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”.

Pas një pushimi, në orën 12:00, do të vazhdojmë me mbledhjen tjetër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”. *(Komisioni përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Robert Bitri, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Klajdi Qama, Zef Shtjefni, Ardit Konomi dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani, Halit Valteri dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Zamir Dedej – Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marika – Drejtoreshë e Biodiversitetit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Niko Peleshi – Fillojmë seancën e datës 06.11.2019, ora 12:00, për shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”. Relatori i këtij projektligji është zoti Andrea Marto.

Po ua jap fjalën relatorit që të bëjë një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje dhe më pas përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të cilët do t’u përgjigjen pyetjeve. Më pas do të vazhdojmë me diskutime, komente dhe në fund do ta votojmë projektligjin.

Fjalën e ka zoti Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i projektligjit është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, si dhe kontributi i vendit tonë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe deteve që kontribuojnë në këtë det.

Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe është një organizatë ndërqeveritare me seli në Monako. Komisioni përbëhet nga të deleguarit e shteteve nënshkruese, që lagen nga Deti Mesdhe, si dhe nga të deleguarit e qeverive të shteteve nënshkruese, që nuk lagen nga ky det, por që kryejnë hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det. Ky Komision është i organizuar në 6 komitete.

Pranimi në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe të shteteve që nuk lagen nga Deti Mesdhe bëhet me miratimin e 2/3-ve të anëtarëve, ndërsa presidenca e Komisionit i takon njërit prej shteteve nënshkruese, që lagen nga Deti Mesdhe.

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe ka si qëllim të kontribuojë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe të deteve që kontribuojnë në këtë det, duke favorizuar punimet hulumtuese në bashkëpunim me institutet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që kanë qëllime të ngjashme, duke nxitur programet multilaterale të mbikëqyrjes së mjedisit detar, si dhe duke lehtësuar shkëmbimet e informacionit dhe botimet veçanërisht në fushën e oqeanografisë, biologjisë ujore, gjeologjisë ujore dhe të biogjeokimisë.

Shtetet nënshkruese angazhohen për një periudhë 5-vjeçare, e cila, me mbarimin e saj, ripërtërihet në heshtje për një periudhë tjetër prej 5 vjetësh.

Shtetet nënshkruese mbështesin një rrjet me disa mijëra studiues detarë, të cilët përdorin mjetet më të fundit shkencore për të kuptuar, për të monitoruar dhe për të mbrojtur më mirë Detin Mesdhe, i cili po ndryshon shpejt dhe po sjell ndikime të mëdha.

Me anëtarësimin në këtë Komision, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Komisioni integron një spektër të gjerë të disiplinave detare, duke përfshirë proceset gjeofizike, kimike dhe biologjike së bashku me hartat me rezolucion të lartë të fundit të detit. Ndryshimet në Detin Mesdhe po ndodhin në mënyrë të shpejtë dhe të pashembullt.

Angazhimi si anëtar i KNESHDM-së sjell si pasojë detyrimin për të derdhur një kontribut vjetor, të përcaktuar nga Byroja. Kuota që duhet të paguajë Shqipëria është në vlerën prej 25 mijë eurosh në vit. Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Marto!

A ka pyetje dhe diskutime nga anëtarët?

Zoti Zamir, si përfaqësues i Ministrisë, a keni diçka për të shtuar lidhur me prezantimin që bëri zoti Marto?

Zamir Dedej - Faleminderit!

Dua të bëj një historik të shkurtër lidhur me arsyen, për të cilën jemi sot këtu. Ka pasur një vizitë të princit të Monakos, i cili është edhe promovues i këtij projektligji. Pra, princi i Monakos e ka mbështetur krijimin e këtij komisioni dhe, si në takimin me Presidentin e Republikës, ashtu edhe me Kryeministrin Rama, është marrë angazhimi, në bazë të kërkesës së tij, për t'u bërë anëtarë. Edhe në vizitën që pati Kryeministri Rama në Monako e përsëriti këtë angazhim dhe, në bazë të këtij angazhimi, ministria jonë dhe Ministria e Punëve të Jashtme u futën në kontakt me Komisionin, duke bërë të gjitha procedurat e nevojshme, siç janë përkthimi i tekstit dhe kalimi për mendim në ministri, ndaj sot kemi ardhur këtu para jush për të kaluar më pas në Presidencë.

Në qoftë se do të pyesni se cilat janë përfitimet e Shqipërisë që të aderojë, është pak e vështirë, sepse Komisioni ka një nivel shumë të lartë, duhet ta pranojmë këtë gjë, dhe vendet e tjera janë shumë më të avancuara dhe kanë një pjesëmarrje të institucioneve që merren drejtpërdrejt me studimin e detit. Ne nuk kemi sot një institucion shkencor, sepse ky është qëllimi, që të merret drejtpërdrejt me studimet. Ministria jonë edhe qeveria e kanë parë këtë projektligj nga një këndvështrim i ri, në mënyrë që në mjedisin detar, i cili ka qenë më pak pjesëmarrës si në zhvillimin e turizmit, ashtu edhe në përfitime, të fillojmë disa aktivitete të tjera dhe kjo do të na ndihmojë ne në këtë proces. Së shpejti ne do të organizojmë një konferencë kombëtare me pjesëmarrës nga faktori ndërkombëtar për të bërë një rezymë se ku jemi dhe çfarë duam të bëjmë. Pra, Komisioni në këtë aspekt do të shërbejë më shumë për të

shqiptarë një proces, i cili ka filluar tashmë në Shqipëri, ndoshta me shpresën që të krijohet edhe një institucion ose një qendër për kërkimet shkencore të detit.

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Për nostalgji dua të bëj një koment të shkurtër. Për herë të parë në marrëveshjen e bërë në Konventën e Barcelonës, e cila është nënshkruar rreth viteve 1991-1992, por Zamiri duhet ta dijë më mirë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, katedra e kimisë analitike dhe organike është përfshirë në monitorimin e bregdetit shqiptar. Deri në vitin 1992 nuk ka pasur asnjë bazë të dhënash, asnjë informacion në lidhje me përbërjen kimike të sedimenteve, ujit dhe biotës. Në atë kohë unë kam qenë shefi i katedrës së kimisë analitike dhe organike dhe, së bashkë me profesor Kosta Koçin, ishim dy nga njerëzit e institucioneve të fakultetit që u përfshimë në monitorimin e të dhënave. Unë e them me keqardhje, Zamiri e njeh shumë mirë këtë proces, se raportet më të mira në lidhje me cilësinë e bregdetit shqiptar, sedimenteve, ujit dhe biotës janë pikërisht në 6 vitet e para. Pra, shpeshherë mungojnë informacionet, baza e të dhënave, raportimet cilësore në lidhje me këtë sektor.

Unë shpresoj që pjesa institucionale e Ministrisë së Mjedisit, veçanërisht përfshirja e institucioneve shkencore të universitetit, pasi një pjesë e këtyre institucioneve nuk i kanë përfshirë ashtu siç duhet, do të bëjë të mundur që kualiteti i të dhënave të jetë në konsistencë sa më të plotë në këtë fushë. Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Ajo që ju thatë është pak e rëndë, në fakt, por unë mendoj se kolegu Baraj është një nga përgjegjësit kryesorë të kësaj çështjeje, sepse ishte kimist, por e la shkencën për t'u futur në politikë; Eduard Shalsi ishte biolog, por e la shkencën për t'u futur në politikë; Klodi ishte biologe, por e la shkencën për t'u futur në administratë; Zamiri ishte biolog, por e la shkencën për t'u futur në administratë, kështu që zgjidheni vetë ju të shkencave këtë punë, sepse vetë e keni bërë këtë gjë. Të gjithë ju e latë shkencën, sepse ju kanë pëlqyer këto gjërat e tjera. Kështu, më vjen keq, por përgjegjës jeni ju vetë. A mund të bëj disa pyetje për projektligjin?

Niko Peleshi – Kjo vlen edhe për ju, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Unë nuk po ankojem.

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Nuk është replikë, madje Zamiri, kohët e fundit, është përpjekur ta rifusë këtë praktikë në institucionet shkencore, por institucionet shkencore janë përjashtuar nga kjo praktikë.

Ilir Beqaj – Nuk ka nge kush të bëjë shkencë...

Besnik Baraj – Jo, jo, absolutisht që ka! Madje, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës ka një staf të mrekullueshëm, që mund ta luajë këtë rol, por i kanë përjashtuar... Nganjëherë i marrin ato PPP-të, se nuk dua të të ngacmoj ty...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Baraj, pale pastaj po të nxjerrim shifrat, sa mjekë kanë kaluar në politikë në kohën kur zoti Beqaj ishte ministër i Shëndetësisë! Si e lejuat atë situatë?! Sa mjekë ka humbur shëndetësia në atë kohë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Jo, mor, jo, është shumë e thjeshtë! Kur donim të fitonim Bashkinë e Ersekës, Nikoja tha: “Vetëm ky doktori e fiton”!

Niko Peleshi – Ore, ti pse e lejove?!

Ti pse e lejove?

Ilir Beqaj – Çfarë të them unë tani?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të bëj disa pyetje?

Niko Peleshi – Po, urdhëroni!

Kthehemi te thelbi i temës. Zoti Beqaj e ka kërkuar fjalën për disa pyetje.

Ilir Beqaj – Ndjesë, nëse nuk e kam zbuluar në relacion, por kur është krijuar ky komisioni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T’i mbaroj të gjitha pyetjet, ju lutem!

E dyta, kjo tarifa e anëtarësisë është e barabartë; është me sipërfaqe deti, që na takon neve në Mesdhe; është me numër popullsie; është me vijën kilometrike të bregut që kemi në Mesdhe, apo si matet? Apo është e gjitha njësoj?

Faleminderit!

Zamir Dedej – Faleminderit!

Tani, për sa i përket krijimit të komisionit, është krijuar në fillim të këtij shekulli, duhet të jetë nga vitet 1900 e ca, nuk e kam të saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të shekullit të kaluar.

Klodiana Marika – Të shekullit XX.

Zamir Dedej – Me iniciativën e princit Alberti i Parë, por nuk e kam datën e saktë.

Klodiana Marika – Është në shekullin e dytë si komision shkencor.

Ilir Beqaj – Jo, dakord, por 100 vjet nuk janë bërë, se Alberti nuk ka bërë ende 100 vjet që ka lindur!

Klodiana Marika – Janë me radhë Albertët.

Zamir Dedej – Ky është Alberti i Dytë, ndërsa ai ka qenë Alberti i Parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është Alberti i Dytë dhe, më duket, i Treti. Po të hap internetin, e gjej se në çfarë date është krijuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është i vjetër si komision dhe është një nga komisionet që jep mendime shkencore për sa u përket aktiviteteve të ndryshme që kryen.

Për tarifën nuk kemi shumë informacion, por është standard, që lëviz nga 22 deri në 25 për vend. Nuk kanë...

Ilir Beqaj – Domethënë, edhe Spanja dhe Italia e kanë 25, edhe ne e kemi 25?

Zamir Dedej – Kështu është.

Klodiana Marika – Japin edhe kontributet...

Zamir Dedej – Pastaj japin kontribute të tjera shtesë. Edhe princi i Monakos bën...

Fee-ja është gati e barabartë, ndërkohë që pastaj kontributet që mbahen, investohen nga qeveritë. Por është *fee* e lartë.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera? Ka diskutime ose komente lidhur me marrëveshjen? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj ka një pyetje.

Zamir Dedej – Më falni, data është 20 mars e vitit 1910!

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Shikoni, në përgjithësi, oqeanografia është shkencë dhe, duke qenë e tillë, merret me ambientin marin, hyn edhe në det, sepse nuk kemi detologji, por oqeanografi. Është terminologji...

Ilir Beqaj – Po lumenologji kemi?

Zamir Dedej – Jo, ka limnologji, që është shkenca e cila merret me ujërat e ëmbla!

Ilir Beqaj – Sa për atë punë, ka edhe liqene të kripura!

Zamir Dedej – Nuk përgjigjem dot për terminologjinë.

Niko Peleshi – E djersite Zamirin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zamir Dedej – Këto janë muhabete disi shkencore, por oqeanografia njihet, ndërsa detologji nuk ka.

Ilir Beqaj – Atëherë, ne injorantët kërkojmë ndjesë që hymë te shkencat!

Zamir Dedej – Ndaj unë nuk marr përsipër të jap përgjigje. Pra, ne nuk jemi një institucion shkencor për detin, kjo është fatkeqësia, duhej të vinin ata sot.

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Në oqean. Domethënë, ti i vëren të pasqyruara në det dhe anasjelltas.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Megjithatë, unë dua të theksoj një fakt, Ilir, që nga këto marrëveshje, pavarësisht se në plan të parë duket që pagesa është ndoshta relativisht e madhe, siç thotë zotëria, por çfarë vjen nga pas, përfitimi që ka Shqipëria në këtë rast është shumë më i madh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse ka të bëjë me projekte të ndryshme, me pajisje, me procese trajnimi.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera ose diskutime brenda temës ose brenda kornizës? Nuk ka. Mirë, atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji dhe me këtë miratim mbylлим edhe seancën për sot.

Faleminderit, kolegë!

Shumë faleminderit edhe përfaqësuesve të Ministrisë!

MBYLLET MBLEDHJA